



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:179918
Datë: 16.08.2024
Numri i dokumentit: 06059130

P.nr. 407/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunorën profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.M...nga Gj..., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale Mospërfillja gjykatës, nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.885/2024 të datës 05.07.2024, të cilën e përfaqëson prokurorja shtetit Leonora Kadriu, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar jo publik, më datë 24.07.2024, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **L.M...**, nga babai R.. dhe e ëma A..., e gjinisë K..., i lindur .., në Gj..., ku edhe jeton, Lagjia "A.", rruga "...", ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punon në picërin "...", në Gj..., i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal l., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i gjykuar për vepër të njëjt penale, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse me datë 25.06.2024, rreth orës 14:52min, në Gjilan në Zyrën e Mbrojtësve të Viktimave i pandehuri , me dashje e ka kanosur, prmes telefonit, seriozisht të dëmtuarën –bashkëshorten e tijë A.S...ashtu që pas mosmarrëveshjeve, mes tyre derisa e dëmtuara ,ka qenë duke dhënë deklaratë, pas ndarjes me të pandehurin, në Zyren e Mbrojtësve të Viktimave, i njëjti në prezencë të dy mbrojtësve të viktimave dhe babait të dëmtuarës Rr.S..., e kanos me SMS me fjalët " prej sodit 99 të juvt jon l e jemja kallxoj kush tka nal prej zemrës tem tplast qekamar nqaff,edhe vllavin kom me ta rujt qysh more hak ti nmu, nbujanovc nkof nevoje kom me rujt dite dhe nat e pa e lon gjys me ja qa barkin sela, ku dush shkoni qka dush boni unë të du ta fali qysh dole ti amo veq sod numri jem ty nuk thirri, mos harro që i ki dy vllazni ngilan e ki babën e ti qysh ma ke bo edhe 10 fish mashum kom me jav bo ", në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tija të kundërligjshme, të dëmtuarës i ka shkaktuar frikë dhe shqetësim emocional.

- Me çka ka kryer veprën penale, Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

II.

Sepse me datë 25.06.2024 rreth orës 14:52 në Gjilan në zyrën e mbrojtësve të viktimave në Gjilan i pandehuri, me dashje nuk e ka respektuar Aktvendimin e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Civil me C.nr.1014/23 të datës 09.08.2023 ashtu që derisa dëmtuara A.S...,ka qenë duke dhënë deklaratë,pas ndarjes me të pandehurin, në Zyren e Mbrojtësve të viktimave, i njëjti në prezencë të dy mbrojtësve të viktimave dhe babait të dëmtuarës Rr.S..., të njëjtën e fton në telefon , ku e shqetëson dhe e kanos me SMS edhe pse i njëjti , sipas aktvendimit e ka të ndaluar që mos ta shqetësoj e kontaktoj në çfarëdo forme, telefonit e -mailit et , në këtë mënyrë i

pandehuri me veprimet e veta nuk ju ka bindë, vendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm divizioni Civil-

- me çka ka kryer veprën penale, Mospërfillja e Gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK.

Prandaj gjykata në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 76 si dhe nenit 364 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin:

E G J Y K O N

I. Të pandehurit L.M..., për veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-s, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro,

-Për veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro,

II. Në bazë të nenit 76 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.4 të KPRK-s, të pandehurit i shqiptohet DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej 1600 € (njëmijë e gjashtëqind) euro të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 90 ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë

III. Të pandehurit të lartcekur, koha e kaluar në paraburgim nga data 26.06.2024 deri më 24.07.2024, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

IV. Nëse i akuzuari refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurin mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënitimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënitimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

III. E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

V. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe 20 (njëzetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 05.07.2024, ka ngritur aktakuzën e lartë cekur, ndaj të akzuarit L.M...nga Gj..., për shkak të veprave penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe Mospërfillja gjykatës, nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 24.07.2024, prezent ishin prokurori i shtetit Leonora Kadriu, i pandehuri L.M..., mbrojtësja e të pandehurit, e caktuar sipas detyrës zyrtare Urata Neziri, e dëmtuara A.S..., pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorës së shtetit, i pandehuri L.M..., ka deklaruar se e pranon fajsinë për kryerjen e veprave penale të cilat i vihen në barrë.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe jo publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe palëve, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit L.M...për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë penale, ekziston fakti se i pandehuri L.M...ka kryer veprat

penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-s, dhe mospërfillja gjykatës, nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin L.M...për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-s, dhe mospërfillja gjykatës, nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin L.M..., si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, kërkim falja të dëmtuarës, pëndimin për veprat penale të kryera, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata merr për bazë dhimbjen dhe shqetsimin e shkaktuar të dëmtuarës A.S..., faktin së i njëjti edhe më herët ka qenë i gjykuar për vepra të njëjta penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurit.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit L.M...duke marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me paraburgimin

Gjykata duke u bazuar konform nenit 79 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të pandehurit koha e kaluar në paraburgim nga data 26.06.2024 deri më 24.07.2024, ia llogariti në dënimin e shqiptuar me gjobë.

8. Vendimi lidhur me kërkesën parurore juridike

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi duke u bazuar në neni 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së, duke e udhëzuar palën e dëmtuar në kontest të rregullt juridiko civil.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale vendosi duke u bazuar në neni 450 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, lidhur me kompensimin e viktimve të krimit gjykata vendosi në bazë të ligjit (LIGJI NR. 08/L-109), nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.407/2024-Më 24.07.2024

Bashkëpunatore profesionale

Kadishe Ajvazi Demi

Gjyqtar,

Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi pala e dëmtuar mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, Departamentit të Përgjithshëm në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.